

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

**31.05.2021  
Ora 10:09**

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim "Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr.43, datë 09.05.2021 të subjektit ankues koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim PD-AN dhe nr.48, datë 10.05.2021 të subjektit ankues Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, për zonën zgjedhore, Qarku Korçë".**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj
- **Parti Politike:** PD, LSI

**Z.E.Çefa:** Mirëmëngjes të gjithëve! Atëherë rifillojmë edhe njëherë sot seancën, për shqyrtimin e kërkesave ankimore, nr.43 të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë – Aleanca për Ndryshim dhe të kërkesës ankimore nr.48, të subjektit ankimes Lëvizja Socialiste për Integrim, me objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me numër 346, datë 04 maj 2021 dhe shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në Qarkun Korçë. Sikurse jeni në dijeni, kjo seancë u ndërpre për shkak se u kërkua nga dy anëtarë të KAS-it, u kërkua administrimi si provë i të dhënave të nxjerra nga pajisja PEI, për këtë qark. Administrata i ka tashmë, që ditën e premte që na e ka sjellë këtë material të përfunduar, besoj duhet t'u jetë shpërndarë edhe palëve?

**Z.Y.Merkaj:** Po!

**Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

**Z.E.Çefa:** Atëherë meqenëse të dyja palët i kemi këtu, pra përfaqësuesin e Partisë Demokratike dhe përfaqësuesin e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, do t'jua jap fjalën që shkurtimisht të thoni diçka lidhur me këtë provë, nëse keni sigurisht. Zoti Logu?

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit, zoti kryesues i seancës! Po është e vërtetë, jemi njohur dhe e kemi marrë provën. Besoj që për më shumë do kemi mundësi të relatojmë dhe momentin e konkluzioneve përfundimtare lidhur me atë që ne kemi dashur të vërtetojmë me anë të kësaj prove. Faleminderit!

**Z.E.Çefa:** Faleminderit! Përfaqësuesja e Lëvizjes Socialiste për Integrim?

**Znj.U.Gjosh:** Përsa i përket provave, nuk kemi gjë për të shtuar, faleminderit!

**Z.E.Çefa:** Ju faleminderit! Atëherë besoj që në këtë fazë, nëse nuk keni prova të tjera për të administruar, ne mund të konkludojmë dhe të përmbyllim fazën e hetimit administrativ për të kaluar në konkluzione. Ndonjë diçka tjetër paraprake, nuk kemi? Prova të tjera, nuk kemi? Atëherë do të kalojmë në konkluzionet përfundimtare duke filluar nga subjekti ankimues Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim. Zoti Logu, fjala për ju!

**Z.M.Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit, zoti kryesues i seancës! Konkluzionet tona i kemi edhe me shkrim, i kemi në 7 faqe. Kemi 3 kopje për KAS-in, në qoftë se mund të afrohem. Zoti kryesues i seancës, Partia Demokratike dhe Aleanca për Ndryshim në datën 09 maj 2021 ka paraqitur përpara këtij

**Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

Komisioni një kërkesë ankimore me objekt kundërshtimin e vendimit, nr.346, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore, Qarku Korçë, duke kërkuar njëkohësisht pavlefshmërinë në zgjedhjet e zhvilluara të datës 25 prill 2021, në këtë zonë, si dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, në të gjithë zonën zgjedhore, Qarku Korçë. Partia Demokratike e Shqipërisë, në emër të Aleancës për Ndryshim, ka paraqitur përpara këtij Komisioni një material ankues prej 57 faqesh, të mbështetur në 45 prova, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar të gjitha shkeljet ligjore, që kanë ndodhur në zonën zgjedhore Qarku Korçë, në periudhën para dhe gjatëzgjedhore, të cilat në vlerësimin tonë përmbushin kriteret e nenit 160 dhe 161 për shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në këtë qark, dhe urdhërimin e përsëritjes së tyre. Partia Demokratike e Shqipërisë ka parashtruar përpara këtij Komisioni se shtetasit: Niko Peleshi-ministër i Mbrojtjes dhe deputet i Partisë Socialiste, Blerina Gjylameti-deputete e Partisë Socialiste, Sotiraq Filo-kryetar i Bashkisë Korçë, Kletiona Kitannënkryetare e Bashkisë Korçë, Ilir Bajlozi-drejtor i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Gjergji Koki-drejtor i Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Besa Spaho-drejtoreshë e Agjencisë Shtetërore së Kadastrës në Korçë dhe kandidatë për deputete e Partisë Socialiste, në bashkëpunim me shtetas të tjerë, drejtues lokal të institucioneve qendrore apo vendore, përfaqësues të Partisë Socialiste, individë të skeduar me rekorde kriminale, kishin ngritur një skemë të blerjes së votave nëpërmjet parave, ndihmave ushqimore, kuponave të kartave të identitetit, etj. Ndaj këtyre shtetasve, ashtu siç është bërë e ditur edhe në seancat e mëparshme, Partia Demokratike ka depozituar në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, 3 kallëzime penale, përkatësisht në datat 02 prill 2021 dhe datën 15 prill 2021 për veprat penale të korrupsionit pasiv dhe aktiv

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

në zgjedhje, përdorimin e funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore, shpërdorimin e detyrës, marrjen ose përdorimin e paligjshëm të dokumentit të identifikimit dhe kanosjen e zgjedhësve. Krahas vlerës së votave përkundrejt shumave nga 100-300 euro, ne kemi parashtruar përpara këtij Komisioni, se me qëllim manipulimin e vullnetit të zgjedhësve, u shpërndanë ndihma ushqimore për familjet në nevojë, apo për fitime të tjera. Sigurisht Partia Demokratike vuri në dispozicion të këtij Komisioni të gjitha provat që ajo dispononte, në nr.45, por për ta vërtetuar deri në fund pretendimin që ne kishim, ne kërkuam nga ana e këtij Komisioni, marrjen e një sërë provash nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Policisë së Shtetit, bashkitë, Drejtoria e Rezervave Materiale të Shtetit dhe Inspektoriatet Qendrore apo inspektoriatet e tjera që veprojnë në Republikën e Shqipërisë. Këto kërkesa u refuzuan nga ana juaj dhe në vlerësimin tonë kjo e ka bërë hetimin, përse i përket këtij aspekti, të cunguar e për rrjedhojë edhe rezultatet e tij do jenë të paplota ose të mangëta. Nga ana tjetër ne kemi parashtruar në mënyrë të përsëritur përpara këtij Komisioni, faktin se si tenderat, prokurimet publike dhe çdo lloj investimi u përdor dhe u vu në dispozicion të Partisë Socialiste. Kemi pasur mundësinë që t'i relatojmë këto fakte gjerësisht në kërkesat tona ankimore e mbase nuk është rasti të ndalemi sërish, por gjithsesi mbetet fakt publik i njohur se dhe në vitin 2020, në të gjithë republikën u prokuruan rreth 878 kontrata publike me vlerë 505 milionë euro ose 500% më shumë se mestarja e pesë viteve të fundit. Sigurisht që provat dhe faktet që ne kishim në dispozicion ishin të mjaftueshme për të krijuar dyshime të arsyeshme përse u përket këtyre pretendimeve, por nga ana tjetër vërtetimi dhe faktimi i tyre i plotë do kërkonte nga ana e këtij Komisioni marrjen e një sërë provash të tjera, pranë bashkive të Qarkut të Korçës dhe Agjencisë së Prokurimeve Publike. Ne parashtruam përpara këtij

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

Komisioni faktin se punonjësit e administratës shtetërore, të të gjitha bashkive të Qarkut Korçë, qoftë në Korçë, Pogradec, Kolonjë, Devoll, Maliq dhe Pustec, u kërcënuan, u intimiduan dhe u vendosën nën presion të vazhdueshëm nga eprorët e tyre për të marrë pjesë detyrimisht në fushatën elektorale të Partisë Socialiste. Për më tepër, ne kemi denoncuar në fakt edhe raste konkrete se si drejtues të institucioneve publike kërcënonin në mënyrë të drejtpërdrejtë punonjësit e tyre për blerjen e kartave të identitetit apo përgatitjen e listave me emra zgjedhësish nga familjaret e tyre. Ne kemi parashtruar përpara këtij Komisioni, rritjen me 13 mijë punonjës të administratës shtetërore, rritjen me 63 milionë euro të shpenzimeve për paga më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm. Kemi parashtruar se konkretisht në Qarkun Korçë, në Bashkinë Korçë, u krijuan 65 pozicione të reja pune, në Bashkinë Pogradec u krijuan 120 pozicione të reja pune, 42 pozicione në Bashkinë Devoll, 26 pozicione në Bashkinë Maliq dhe 10 pozicione pune në Bashkinë Pustec. Është e qartë se neni 91, pika 3 e Kodit Zgjedhor, ndalon në fakt çdo lloj punësimi që duhet të kryhet në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve, përveç rastit kur këtë e diktojnë nevojat e ngutshme. Deri më tani ne nuk kemi parë as publikisht, por as nga kërkesat për informacion që ne kemi dërguar si Parti Demokratike, ndonjë informacion përsa i përket, se cilat kanë qenë nevojat e ngutshme që kanë diktuar punësimet masive në Bashkinë Korçë, në Bashkinë Pogradec, Devoll, Maliq apo Bashkinë Pustec. Sigurisht ashtu si në raste të tjera, ne kërkuam në mënyrë të përsëritur që pretendimet tona të vërtetoheshin deri në fund, nëpërmjet marrjes së provave, pranë departamentit të administratës publike, bashkive të Qarkut Korçë, shoqërive aksionare në pronësi të shtetit, agjencive të varësisë të ministrive apo bashkive, për të gjithë punonjësit e rinj në periudhën janar-prill 2021, qofshin këta me kontrata të përkohshme, apo qofshin me kontrata të përhershme. Po ashtu është fakt publik dhe tashmë i përsëritur, se

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

dhënia e ndihmës ekonomike, shtesa që u vu në skemën e ndihmës ekonomike të një numri shumë të konsiderueshëm familjesh dhe rreth 2.6 milionë euro më shumë pagesa për ndihmë ekonomike se e njëjta periudhë e vitit të mëparshëm, edhe për këtë informacion ne kërkuam të merreshin prova pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në cilësinë e ministrisë përgjegjëse apo ministrisë së linjës, si dhe bashkive të Qarkut Korçë. Të gjitha këto informacione, se të gjithë jemi koshient besoj këtu, por kudo janë refuzuar nga ana juaj në kundërshtim me nenin 137 të Kodit Zgjedhor. Fakte të tjera publike siç janë lejet e legalizimit, ku vetëm në fshatin Dërsnik, drejtuesi politik i Qarkut, i shoqëruar nga shtetasit Sotiraq Filo dhe Artan Lame përkatësisht kryetari i bashkisë Korçë dhe drejtori i Përgjithshëm i Kadastrës është fakt publik se vetëm në një fshat siç është Dërsniku, u shpërndanë në një aktivitet publik 400 leje legalizimi, për të cilat Partia Demokratike në datën 03 prill 2021 ka depozituar një kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë. Jemi të bindur se përmasat e këtij fenomeni janë disa herë më të mëdha dhe disa herë më shqetësuese dhe kjo ishte pikërisht arsyeja që ne kërkuam nga ana e këtij Komisioni që të merreshin informacione në cilësinë e informacioneve zyrtare, në cilësinë e provës, për të vërtetuar se sa ishte numri i lejeve të legalizimit, të shpërndara në Qarkun Korçë, në periudhën janar-prill 2021, pasi ne mbetemi të bindur se lejet e legalizimit, lejet e ndërtimit apo lejimi i ndërtimeve pa leje, u përdorën si një mjet në dispozicion të partisë në pushtet, për ta përkthyer në vota dhe mbështetje për kandidatët e saj. Fakte të tjera që kanë të bëjnë me të dhënat personale, ndalimin e të drejtës së 500 mijë shtetasve shqiptarë me të drejtë vote për të votuar, apo mohimin e të drejtës që iu bë të infektuarve me Covid 19 dhe së fundmi sigurisht, edhe votimin e shumëfishtë apo votimin familjar, janë shkelje të tjera të rënda të ligjit, të cilat në vlerësimin tonë kanë cenuar procesin zgjedhor të 25 prillit, në Qarkun e Korçës. Sigurisht që fakt po ashtu i rëndësishëm për t'u

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

pasur në vëmendje të këtij Komisioni është edhe fakti që në Qarkun Korçë, si rezultati i një vendimi, në vlerësimin tonë, në kundërshtim me nenin 98 të Kodit Zgjedhor dhe pikës 27, të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore, sa i përket fletës së votimit, sollu si rezultat vetëm në Qarkun e Korçës, mbi 7375 fletë votimi të pavlefshme, të cilat në vlerësimin tonë do kishin bërë diferencën edhe në rezultatin e zgjedhjeve. Fatmirësisht të dhënat që arritëm të marrim nga pajisjet e identifikimit elektronik PEI, na mundësuan disa të dhëna, të cilat janë mjaft shqetësuese. Shenjat e gishtërinjve të 23 personave janë përdorur për identifikimin e 63 zgjedhësve, potencialisht ashtu siç kemi pasur mundësi të relatojmë dhe në seancat e tjera, kjo do të thotë që 23 persona mund të kenë votuar 63 herë ose 3 herë për person. Sigurisht që të gjitha këto shkelje, pra rastet flagrante të blerjes së votave nga Partia Socialiste, nga drejtues të Partisë Socialiste me individë me rekorde kriminale, shkrirja e shtetit me partinë në një të vetme, vjedhja dhe përdorimi i paligjshëm i të dhënave personale, mohimi i të drejtës së 500 mijë shtetasve për të votuar, pavlefshmëria e vullnetit të 7375 qytetarëve në Qarkun e Korçës apo raste flagrante të votimit të shumëfishtë, në vlerësimin tonë provojnë shkeljet apo në përmbushje të kriterëve ligjore të përcaktuara nga neni 160, për sa i përket shkeljeve të rënda që cenojnë procesin zgjedhor e për rrjedhojë ky Komision duhet të konkludojë me pavlefshmërinë e zgjedhjeve dhe përsëritjen e tyre. Sigurisht nuk kemi pse ta mohojmë dhe është e rëndësishme dhe për procesin që zhvillojmë këtu, apo për procesin që mund të zhvillohet në hallkat e tjera, se refuzimi në mënyrë të përsëritur i kërkesave për marrjen e provave nga organet e administratës publike, e cila në vlerësimin tonë është plotësisht në përputhje me nenin 137 të Kodit Zgjedhor, e ka cunuar këtë hetim, e ka bërë atë të mangët dhe të paplotë, duke cenuar një të drejtë që në fakt i garantohet çdo pale në një proces administrativ, e cila është e drejta për një proces të rregullt ligjor, e cila pikë së pari

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021**

nënkupton garantimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm për të gjitha pretendimet që ngrenë palët përpara një organi, qoftë ky organ administrativ apo qoftë organ gjyqësor. Shpresojmë shumë që kjo mangësi, kjo paplotësi në kryerjen e hetimeve nga ana e këtij Komisioni të mos jetë e tillë edhe në vendimin përfundimtar që do marrë ky Komision. Prandaj në përfundim i nderuar, bazuar në gjithçka relatuam më sipër, për gjithçka që kemi pasur mundësi të relatojmë edhe më herët përgjatë parashtrimeve tona apo seancave të tjera, përfundimisht kërkojmë që në përputhje me nenin 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor, shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve, për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, në zonën zgjedhore Qarku Korçë dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në këtë zonë, faleminderit!

**Z.E.Çefa:** Ju faleminderit zoti Logu! Përfaqësuesja e Lëvizjes Socialiste për Integrim e keni fjalën!

**Znj.U.Gjoshja, përfaqësuesja e LSI-së:** Faleminderit! Atëherë të nderuar anëtarë të KAS, ne si subjekt, përsa është debatuar dhe në hetimin administrativ, përfundimisht kërkojmë ndryshimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nr.346, datë 04.05.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Korçë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021. Faleminderit!

**Z.E.Çefa:** Atëherë ju faleminderit! Përfaqësuesi i palës së interesuar, Partisë Socialiste, nuk ndodhet në këtë seancë, kështu besoj që nuk e ka konsideruar aq të rëndësishme që të japë dhe ai konkluzionet e tij. Atëherë, unë e deklaroj të mbyllur

**Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA**





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

seancën! KAS do tërhiqet për vendim dhe do të rishihemi për 15-20 minuta. Ju faleminderit!

**Rifillon mbledhja**

**Ora 10:50**

**Z.E.Çefa:** Atëherë KAS, pasi e vlerësoi çështjen në tërësi, pasi analizoi provat dhe faktet e paraqitura, bazuar në shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 30, të vendimit nr.3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator dhe bazuar në Kodin Zgjedhor, me shumicën e votave vendosi:

Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.43, të datës 09 maj 2021, të paraqitur nga subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë-Aleanca për Ndryshim,

rrëzimin e kërkesës ankimore nr.48, datë 10 maj 2021, të paraqitur nga subjekti ankimues Lëvizja Socialiste për Integrim,

lënien në fuqi të vendimit nr.346, datë 04 maj 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ndaj këtij vendimi palët mund të paraqesin ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi. Seanca deklarohej e mbyllur!

**Vendimi nr. 93**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**31.05.2021  
Ora 10:52**

**RENDI I DITËS**


**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr40, subjekti ankues PD-AN, Qarku Elbasan.”**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:**                   **Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Ilirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO**
  
- **Stafi KQZ:**   **Y.Merkaj, O.Peto**
  
- **Parti Politike:** **PD, PS, LSI**

**Z. E. Lako:** KAS në përfundimin e shqyrtimit administrativ të kërkesës ankimore nr. 40 bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara në mbështetje të nenit, të shkronjës “d” të pikës 1, të nenit 30 të vendimit nr. 3, datë 16.11.2020 të Komisionit Rregullator me shumicë votash vendosi:

- 1.Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 40, datë 09.08.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni PD-AN.
- 2.Lënien në fuqi të vendimit nr. 344, datë 04.05.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit zgjedhor të zonës zgjedhore Qarku Elbasan për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.
- 3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.



*-Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

4.Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e tij.

Faleminderit dhe tani do të vazhdojmë me ankimet për Qarkun Fier.

**Vendim nr.94**

*Zbardhi materialin audio*

*Jonida SALILLARI*



31.05.2021

Ora 10:53

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 44, datë 09.05.2021 të subjektit ankues koalicioni Partia Demokratike – Aleança për Ndryshim PD – AN, për zonën zgjedhore Qarku Fier.”**

**PJESËMARRJA :**

- **KAS:** Z.Elvin LAKO, Z.Elvis ÇEFA, Z.Illirjan RUSMALI,  
Z.Koli BELE, Z.Ledio BRAHO
- **Stafi KQZ:** Y.Merkaj, O.Peto
- **Parti Politike:** PD, PS, LSI

**Z. I. Rusmali:** Riçelim seancën për kërkesën ankimore për Qarkun e Fierit. Prezent në seancë janë përfaqësuesi i palës ankuese, zoti Logu dhe përfaqësuesja e palës së interesuar Lëvizja Socialiste për Integrim, mungon përfaqësuesi i palës së interesuar Partia Socialiste. Ju jeni njohur me provat besoj ndërkohë që u morrën?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Jemi njohur me provat lidhur me të dhënat nga pajisjet PEI. Ndërkohë që provat e tjera që u kërkuan nga ana juaj nuk na janë vënë në dispozicion.

**Z. I. Rusmali:** A mund të bëhet kopje për ta? Domethënë kopje të këtyre materialeve për palët? Të lutem edhe për anëtarët po mirë, mund të fillojmë. Keni

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Proçesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

nevojë të bëni analizën e asaj që keni marrë në dispozicion apo do ta bëni bashkë me pretendimet përfundimtare?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Do ta bëjmë bashk me konkluzionet përfundimtare. Këto që kemi domethënë të dhënat e pajisjeve PEI.

**Z. I. Rusmali:** Përfaqësuesja e LSI-së do të bëjë një koment rreth provës së kryqëzimit të pajisjeve?

**Znj. U. Gjoshi, përfaqësuese e LSI-së:** Jo, nuk kemi diçka për provat.

**Z. I. Rusmali:** Atëherë, unë i kërkoja, ne i kërkuam Administratës që të verifikojnë atë tabelë rezultatesh për 1 qendër votimi, QV nr. 30793 nëse përputhet me bazën e të dhënave që ka zyrtare të të dhënave. Administrata çfarë thotë zoti Merkaj lidhur me këtë tabelë? Tabelën për këtë QV janë të sakta të dhënat?

**Z. Y. Merkaj:** Po të sakta janë.

**Z. I. Rusmali:** Të dhënat janë të sakta, mirë. Kemi një tabelë për rezultatin e votimit për Partinë Socialiste në qendrat e votimit të fshatit Buzëmadh, Njësia Administrative Cakran. Ju keni të dhënë rezultatin për 2019 që ne në fakt nuk na hyn në punë dhe rezultatin për 2017. Ndërkohë që na duhej rezultati për 2021 dhe për 2017, dy të dhëna që janë të krahasueshme me njëra – tjetrën. Dakord, mirë do të.. mund të ecim me pretendimet përfundimtare derisa të na vijë prova dhe pastaj

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

në fund mund të shprehemi dhe veçantë rreth tyre. Mund të bëni koment të veçantë, po zoti Logu.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti kryesues i seancës. Meqenëse i morëm këto tabela besoj dhe në momentin që do të relatohet nga ana juaj si dhe qëllimi që i morëm këto prova do të kemi mundësi dhe ne të mbajmë një qëndrim. Për sa kohë që, po themi këto janë shifra me të cilat sigurisht nuk dyshojmë në vërtetësinë e tyre nga administrata.

**Z. I. Rusmali:** Jo, unë po i'ua them kush është qëllimi pa bërë analizën e shifrave. Juve analizën mund ta bëni vetë pastaj, sepse nuk ka sens të bëjmë analizën kur nuk disponohet prova.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Dakord.

**Z. I. Rusmali:** Ka patur një pretendim lidhur me kallëzimin penal nr. 41, provën nr. 41 që ju keni për veprimtari të paligjshme të Drejtorit të Burgut Fier, i çili sipas kallëzimit u ka kërkuar të burgosurve që të votojnë me një mënyrë specifike të çaktuar. Kjo është përmbajtja e kallëzimit dhe unë kam dashur të ballafaqoj këtë gjë që thuhet në kallëzimin me rezultatin real në qendrën e votimit. Pas zgjedhjeve ne kemi mundësinë ta bëjmë këtë gjë dhe tabela përmbledhëse këtë fakt. Lidhur me qendrat e votimit të fashtit Buzëmadh ka një kallëzim penal specifik që flet për një numër personash, domethënë kallëzimi flet për emra të përvetshëm. Domethënë ka një numër personash me emra dhe mbiemra, të cilët janë punësuar. Nuk bëhet e qartë kur është periudha e punësimit, por thuhet janë punësuar nga ky fshat në një

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

operator shtetëror publik. Analiza krahasuese e të dhënave të 2017 me 2019 kërkon të shqyrtojmë a ka impakt në rezultatin e Partis Socialiste për këto qendra votimi, fakti i punësimit të 9-të ose 11-të, sepse nuk e mbaj mend tani nuk e kam përpara, por numri ka qenë domethënë i saktë në kallëzim. Ky ka qenë qëllimi i kësaj gjëje, krahasimi i të dhënave për rezultatin e subjektit në raport me një ngjarje që kallëzohen nga ana juaj. Në këtë kontekst do shikoni dhe ju pastaj rezultatin, sepse unë nuk e kam tani.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Domethënë, duke qenë se këto të fshatit Buzëmadh nuk e kemi akoma. Besoj mund të bëjmë një koment lidhur me këtë sa i përket, po themi burgut të Fierit që janë të plota?

**Z. I. Rusmali:** E morët?

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Këtë e kemi domethënë.

**Z. I. Rusmali:** Dakord, në rregull.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Atëherë..

**Z. I. Rusmali:** A është rezultat i 2021? Dakord, mirë le të na e konfirmojnë ata. E rëndësishme është që ne jemi përpara situatës që na duhet krahasimi me 2021 jo me 2019, sepse nuk ka sens krahasimi me 2019. Mirë, zoti Logu.

*Zbardhi materialin audio  
Jônida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Lidhur me këtë të dhënë për burgun e Fierit për QV nr. 30793 kallëzimi penal i Partisë Demokratike. Zoti Rusmali siç i'u është vënë në dispozicion edhe juve në cilësinë e provës materiale, po themi ne kemi paraqitur faktin se Drejtori i Burgut të këtij burgu pra, të Burgut të Fierit shtetasi Arjan Hasani i'u ka kërkuar po themi drejtuesve dhe punonjësve të këtij institucioni, por edhe të burgosurve që të votojnë për nr. 10 në Qarkun Fier, numër i cili mbahet nga Kryetari i Parlamentit shtetasi Gramoz Ruçi.

*Zbardhi materialin audio  
Jonida SALILLARI*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Në fakt, nga tabela që ju na keni vënë në dispozicion rezulton se vota për kandidatë të PS-së në këtë qendër votimi ka pasur 67 vota nga të cilat 26 prej tyre i ka marrë shetasi Gramoz Ruçi, ose 38.31% pra në vlerësimin tonë provon atë që ka pasur një orientim të qartë për të votuar nr.10 të listës së PS-së. Kaq po themi mund të jetë komenti jonë për këtë provë që konfirmon dhe pretendimin që është ngritur nga ana jonë. Për sa i takon fshatit Buzëmadh për të cilin ne kemi bërë një kallëzim penal dhe kemi ngritur pretendimin që janë punësuar një numër i caktuar punonjësish në këtë zonë ka dy qendra votimi 3095 dhe 3096 dhe po të shohim dhe në përqindje shihet se ka një rritje votuesish për PS-në. Pra në fshatin Buzëmadh 3095 ka pasur 153 votues për PS-në, sot ka 194 në terma përqindjesh janë 34,38% ndërkohë që sot ka 58.43% ndjesë.

**Z. L. Braho:** Është 60.25% është thjeshtë një lapsur në tabelë pra është më shume se 58.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Dakord, të paktën nga këto po i marrim të mirëqena faktet dhe materialet që na janë sjellë nga administrata zgjedhore pastaj nqs ju duhet të bëni korrigjime sigurisht që duhet të qendrojnë. Dhe e njëjta gjë dhe në qendrën e votimit 3096 ku ka një rritje nga 25% në 43%. Pra edhe ky informacion që u morr nga anëtarët e KAS-it konfirmon pretendimet tona që punësimet që janë kryer pikërisht nga banorë të fshatit Buzëmadh që janë punësuar nga administrata publike ka ndikuar më pas që rezultati i PS-së të ndryshojë nga 34 në 58 në njërën qendër votimi dhe nga 25 % në 43 % në qendrën tjetër të votimit. Të dyja këto prova në fakt konfirmojnë pretendimin që është ngritur nga ana e PD-së, faleminderit. Më shumë do kem mundësi që të relatojmë dhe nga

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

pretendimet apo konkluzionet tona përfundimtare. Zoti Rusmali nqs ka paqartësi në këtë tabelë do lutesha që përpara se të shpreheni përfundimisht të ketë një korrigjim të lapsuseve, siç u shpreh dhe zoti Braho.

**Z. L. Braho:** Unë i pashë këto përqindje nga aplikacioni i KQZ-së dhe nga aplikacioni i KQZ-së për qendrën e votimit 3095 është 60.95%, ndërkohë që në 2017 ka qenë 34.38.

**Z. I. Rusmali:** Nga ato që kam konstatuar unë më rezulton 60.25%

**Z. L. Braho:** Ndërkohë që 3096 sipas tabelës është 42.91 ndërkohë nga aplikacioni del 45.6 në 2021.

**Z. I. Rusmali:** Edhe mua më rezulton 45.6 nga aplikacioni.

**Z. N. Mezani:** Në faqen e internetit derisa të dalë vendimi i Kolegjit Zgjedhor mbi ndryshimet përfundimtare ajo në faqen e internetit ka momentin e rezultatit paraprak për përfundimin e zgjedhjeve. Pra do të bëhen ndryshimet e fundit dhe do të reflektohen dhe në faqen WEB. Kurse kjo, votat janë nxjerrë nga sistemi, votat që ju keni në tabelë 19 është 21 ka qenë një lapsus i imi kurse 58.43 është për QV 3095 dhe 34.38 për 2017 respektivisht e njëjta.

**Z. L. Braho:** Pyetja është përqindja është 58.43 apo 60.25?

**Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

**Z. N. Mezani:** 58.43 është aktualisht nga sistemi por ne nuk i kemi bërë ndryshimet në WEB derisa të dalin vendimet përfundimtare të numërimit. Nuk bën diferencë të madhe.

**Z. I. Rusmali:** Nga verifikimet e mija, mbase e kam gabim por më rezulton që në 2017 në fshatin Buzëmadh kanë qenë 3 qendra votimi, 3095 siç është aktualisht, 3096 siç është aktualisht dhe 3096. E cila është bashkuar me 3096 në këto zgjedhje. A ka qenë kështu?

**Z. N. Mezani:** Po, korrekt.

**Z. I. Rusmali:** Për të bërë krahasimin na duhet dhe 30961 se njësia është fshati.

**Z. N. Mezani:** Në 2021 fshati Buzëmadh ka 2 QV në shkollën e këtij fshati dhe në 2017 kanë qenë 3 QV. Kështu që krahasimi i QV së 3 nuk ka me kë të bëhet në 2021.

**Z. I. Rusmali:** Jo, e dua me 2017. Unë dua çfarë ka pas fshati në 2017 ta krahasojë më çfarë ka pasur në 2021. Referenca është fshati nuk është një QV apo tjetra. Personat e punësuar nuk i ndajmë dot në cilën qendër kanë qenë votuesit por i ndajmë sipas kallëzimit që kanë qenë banorë të atij fshati apo jo? Dhe na duhet votimi në fshat jo në qendra të caktuara.

**Z. L. Braho:** Po se duhet të sqarojmë dhe kjo 30961 është bashkuar me 3096 apo më ndonjë qendër tjetër? Pra vazhdon i përket fshatit Buzëmadh?

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Nuk mund ti përkasë askujt tjetër përveç fshatit se është bashkia, zona.

**Z. Y. Merkaj:** Meqënëse ka ndryshuar Kodi Zgjedhor, ka thënë që jo më pak se 300 zgjedhës dhe jo më shumë se 1000 atëherë qendrat e votimit që kanë më pak se 300 zgjedhës bashkohen me qendrën tjetër të votimit.

**Z. I. Rusmali:** Më të afërtën.

**Z. Y. Merkaj:** Në këtë rast është qendra bijë që ka fraksion te qendra mëmë.

**Z. L. Braho:** Pra i bie është prapë fshati Buzëmadh.

**Z. Y. Merkaj:** Po. Është bërë një qendër votimi këtu që të bashkohen. Punë 5 minutash mund të sjellim dhe rezultatin.

**Z. I. Rusmali:** Po ta sillni mund ta përdorim. Po të mos ta sillni do të themi që nuk ka vlerë eksplorimi jonë se nuk është material i krahasueshëm. Por e mira është të kuptoni që ne duam këtë të dhënë dhe e mira është që kjo e dhënë të analizohet nga të gjitha palët. Atëherë mirë, kalojmë zoti Logu te pretendimet përfundimtare.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit, zoti kryesues i seancës, pretendimet përfundimtare të PD- AN janë dhe më shkrim janë në 7 faqe. 3 kopje janë për anëtarët e KAS-it nqs mund të afrohet tek ju apo t'ja u lejë administratës zgjedhore.

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** PD-AN në datën 9 maj 2021 ka paraqitur pranë KQZ-së një kërkesë ankimore me objekt kundërshtimin e vendimit nr.348 datë 04.05.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatin në zonën zgjedhore Qarku Fier duke kërkuar njëkohësisht pavlefshmërinë e zgjedhjeve të datës 25 prill 2021 në këtë zonë dhe urdhërimin e përsëritjeve të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në gjithë zonën zgjedhore Qarku Fier në një periudhë sa më të afërt. Partia Demokratike e Shqipërisë në emër dhe të PD-AN ka paraqitur përpara këtij komisioni një material ankues prej 71 faqesh të mbështetur në 89 prova duke shpjeguar në mënyrë të detajuar të gjitha shkeljet ligjore të zonës zgjedhore Qarku Fier të cilat në vlerësimin tonë përmbushnin kushtet e nenit 160 dhe 161 të Kodit Zgjedhor për shpalljen e pavlefshmërisë dhe urdhërimin e përsëritjeve në këtë qark. Konkretisht PD-AN ka parashtruar nëpërmjet një numri të madh faktesh dhe grup faktesh sesi shtetas me pozicione të larta drejtues në Administratën Shtetërore apo atë lokale, konkretisht Erion Braçe, Armando Subashi, Fredi Kokoneshi, Majlinda Zeqaj etj në bashkëpunim me shtetas që janë të njohur dhe të skeduar për rekordet e tyre kriminale kishin ngritur në Qarkun e Fierit një strukturë të mirëfilltë kriminale e cila blinte vota qoftë kjo nëpërmjet parave, ndihmave ushqimore, kuponave të ID, dhënies së përfitime të tjera me burim të drejtpërdrejtë buxhetin e shtetit apo dhe aktivitete të paligjshme të cilat janë para të pista. Sigurisht blerja e votave nuk kryhej vetëm nëpërmjet dhënie së përfitimeve por kishte dhe mekanizma të tjera siç ishin kërcënimet apo presionet e drejt përdrejta ndaj zgjedhësve të cilat ne i kemi shpjeguar në materialin tonë ankimor. Ndaj këtyre shtetasve të përmendur dhe të tjerëve të cilët nuk po i citoj për efekt kohë, PD ka depozituar në SPAK dy kallëzime penale në datën 2 prill

*Zbardhi materialin audio*

*Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

2021 për veprat penale të korrupsionit aktiv dhe pasiv në zgjedhje, përdorimin e funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore, shpërdorimin e detyrës, marrjen apo përdorimin e paligjshëm të dokumentit ID. Nga ana tjetër siç kemi pasur mundësi të relatojmë në mënyrë të përsëritur përpara këtij komisioni vetëm në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Fier, PD ka depozituar rreth 43 kallzime penale për krime që nuk hyjnë në juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme por bëjnë pjesë në juridiksionin e Prokurive të Përgjithshme. Sigurisht që krahas provave që patëm mundësi t'ju paraqesim dhe relatojmë përpara këtij komisioni ku përfshihet gjithçka, informacione, të dhëna, indicie, ne kërkuam për të bërë transparencë të plotë dhe për të vërtetuar deri në fund qendrueshmërinë apo bazueshmërinë e këtyre pretendimeve të merreshin informacione zyrtare në cilësinë e provës pranë prokurorive, qoftë Prokurorisë së Posaçme apo Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Policisë së Shtetit, bashkive të cilat në vlerësimin tonë, në tërësinë e tyre do të kishin provuar qendrueshmërinë e pretendimeve tona lidhur me faktin se blerja masive e votës në Qarkun e Fierit ishte një nga problematikat kryesore të zgjedhjeve të 25 prillit. Po ashtu ne kemi parashtruar përpara këtij komisioni në fakt se si shteti vendosi në dispozicion të PS-së çdo tender, koncesion , PPP dhe çdo lloj investimi tjetër publik duke sjellë raste konkrete të paktën 32 raste janë evidentuar nga ana jonë të përdorimit të investimeve publike, intimidimit të administratës shtetërore apo përdorimit të paligjshëm të burimeve shtetërore për të cilat PD ka depozituar në mënyrë të vazhdueshme kallzime penale pranë prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm të Qarkut Fier. Konkretisht ne kemi përmendur edhe në kërkesën tonë ankimore por edhe në pretendimet tona përfundimtare shtetas konkret të cilët janë drejtues dhe kanë pozicione të larta në administratën publike, kam parasysh këtu shtetasin Gramoz Ruçi me detyrë Kryetar i Kuvendit, Erion Braçe Zëvendës Kryeministër, Armando Subashi

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

Kryetar i Bashkisë Fier, Fredi Kokoneshi Kryetar i Bashkisë Divjakë, Fatos Tushe Kryetar i Bashkisë Lushnje, Bujar Çela deputet i PS-së të cilët në bashkëpunim edhe me shtetas të tjerë u shfaqën në mënyrë të përsëritur në promovimin e investimeve publike në Qarkun Fier me qëllime të pastra elektorale. Po ashtu kemi pasur mundësi të parashtriojmë përpara këtij komisioni nga të dhënat e siguruar nga të dhënat e siguruar nga rregjistrat publik të Agjensisë së Prokurimeve Publike se në vitin parazgjedhor 2020 u prokuruan 878 kontrata publike me vlerë 505 milion euro ose 500% më shumë se mesatarja e 5 viteve të fundit. Sigurisht që provat që kemi pasur në dispozicion kërkonin që të përqaseshin e vërtetoheshin deri në fund qoftë pranë bashkive të Qarkut Fier apo Agjencisë së Prokurorimeve Publike të cilat në vlerësimin tonë do të provonin katërciprisht pretendimin që kemi ngritur përpara këtij komisioni lidhur me përdorimin masiv që ju bë burimeve, asetëve dhe parave të buxhetit të shtetit për ti vënë ato në përdorim të PS-së në Qarkun e Fierit. Kemi pasur mundësi të parashtrojmë gjerësisht sesi administrata publike në bashkitë socialiste të Qarkut Fier, në fakt të gjitha bashkitë e Qarkut Fier drejtohen nga kryebasjkiak socialist, u vendosën nën presion e kërcënim të vazhdueshëm për të marrë pjesë në fushatën elektorale të PS-së dhe po ashtu kemi pasur mundësi të prashtrojmë përpara këtij komisioni një rritje të pa bazuar në arsye objektive të administratës qoftë kjo administratë shtetërore qendrore apo lokale në Qarkun e Fierit.

*Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

*Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:* Konkretisht ne kemi sjellë përpara jush faktin se shtetasi Arjan Fasko, me detyrë drejtor i OSSHE-së për jugun, ka punësuar rreth 80 persona në kërkim të kërkimit për të votuar PS-në, kryesisht në zonat e “Cakranit”, të “Kreshpanit”. Ne i kemi përmendur me emra dhe mbiemra. Sigurisht nuk do të donim ti sillnim këtu për efekt të të dhënave personale. Këta persona, të cilët janë punësuar, të cilët në vlerësimin tonë, të mjaftonte dërgimi i një shkresë të thjeshtë me dy paragrafë për të provuar deri në fund, qëndrueshmërinë ose bazueshmërinë e këtij pretendimi. Po ashtu ne kemi parashtruar para jush faktin se Baftjar Zeqaj me detyrë Drejtor i Kompanisë Albpetrol, kishte punësuar mbi 100 persona në administratën e kësaj kompanie shtetërore në këmbim të votës. Edhe për provimin e këtij fakti do të kishte mjaftuar në çdo rast një shkresë e thjeshtë drejtuar institucionit, asgjë më shumë në fakt se thjesht vullneti i anëtarëve të këtij komisioni dhe një shkresë me dy paragrafë. Po ashtu ne ju parashtruar se administrata e Bashkisë Mallakastër dhe Roskovec kishin pësuar një rritje të konsiderueshme të numrit të punonjësve të tyre në periudhën janar-prill 2021. Për këdo në këtë komision është e qartë se punësimet 4 muaj përpara zgjedhjeve janë të ndaluara, përveç se kur atë e diktojnë nevojat e ngutshme të çdo institucioni dhe sigurisht për të gjitha këto punësime që ne kemi parë deri më sot, as publikisht por as nëpërmjet kërkesave që kemi dërguar për informacion, nuk kemi pasur ndonjë të dhënë, ndonjë informacion, ndonjë deklaratë zyrtare se cilat ishin nevojat e ngutshme që diktuan punësimet në administratat e këtyre organeve që sapo përmendëm. Sigurisht që PD – AN pati mundësinë të sjellë provat e saj përpara këtij komisioni, të cilat në vlerësimin tonë ishin të mjaftueshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm mbi ekzistencën e këtyre shkeljeve të rënda ligjore, të cilat duhet të provoheshin më pak edhe nëpërmjet provave të tjera që ne i kërkuam këtij institucioni të merrte në përputhje me nenin 137 të Kodit





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

Zgjedhor dhe për të cilën të gjithë e dimë, janë refuzuar në mënyrë të përsëritur. Po ashtu ne kemi pasur mundësinë të parashtrojmë përpara këtij komisioni faktin se lejet e legalizimit dhe lejet e ndërtimit ishin një tjetër mjet që u përdor masivisht, kudo në të gjitha qarqet e Shqipërisë, por edhe në Qarkun e Fierit për t'i përkthyer në vota dhe mbështetje për Partinë Socialiste dhe kandidatët e saj. Në të paktën 9 raste të kallëzuara në Prokurori, zyrtarët e lartë qendrorë apo lokalë të Partisë Socialiste premtuan apo shpërndanë leje legalizimi si dhe lejuan ndërtime pa leje në këmbim të votës, për shtetas të ndryshëm në Qarkun e Fierit. Sigurisht që ky është një pretendim, të cilin ne e mbështetëm në një numër provash që sollën përpara këtij komisioni, por që për ta vërtetuar dhe provuar deri në fund ishte e nevojshme që ky komision t'i drejtohej Bashkive të Qarkut të Fierit dhe Këshillit Kombëtar të Territorit, sa i përket numrit të lejeve të ndërtimit të dhëna në këtë periudhë dhe sigurisht edhe Agjenci Shtetërore të Kadastrës se sa ishte numri i lejeve të legalizimit, të dhëna në periudhën janar-prill 2021 në Qarkun e Fierit. Po ashtu kemi pasur mundësi në mënyrë të përsëritur të shpjegojmë gjerësisht në fakt, fakte të njohura publike siç janë vjedhja dhe përdorimi i paligjshëm i të dhënave personale. Ndalimi i së drejtës i 500.000 shtetasve shqiptarë të drejtë vote në Greqi dhe Maqedoninë e Veriut për të votuar. Fakt, numri jashtëzakonisht i madh i fletëve të votimit në të gjithë Shqipërinë, rreth 33.000 ose vetëm në Qarkun e Fierit 9.375 fletë votimi, për të cilat jemi të bindur që do të kishin sjellë edhe diferencë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve në këtë qark, apo edhe votimin e shumëfishtë, ku të dhënat e marra nga pajisjet PEI flasin se shenjat e gishtërinjve të 35 personave janë përdorur për identifikimin e 91 zgjedhësve, çka pontecialisht krijon dyshimin se 35 persona kanë votuar 91 herë, ose së paku 3 herë secili. Ne mendojmë se dhe Qarku i Fierit, e veçanërisht Qarku i Fierit ku ka një numër të madh kallëzimesh penale, rreth 74, ku ka kallëzime qoftë në Prokuroritë e

14

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

Posaçme apo në prokuroritë e juridiksjonit të përgjithshëm, ku ka ankime në organet administrative. Ka raste flagrante të shkeljeve të ligjit, qofshin ato lidhur me shitblerjen e votës nga drejtues të Partisë Socialiste me rekorde kriminale. Qofshin rastet e shkrirjes së shtetit dhe partisë në një të vetëm, qoftë rasti i vjedhjes dhe përdorimit të të dhënave personale, qoftë rasti i mohimit të së drejtës së 500.000 shtetasve për të votuar, të pavlefshmërisë së vullnetit të 9.375 zgjedhësve apo rasteve të votimit të shumëfishtë, votimi familjar, votimi për të tretët e kështu me rradhë. Sigurisht që edhe prova që u kërkua nga ana e dy anëtarëve të këtij komisioni sa i përket një kallëzimi penal që ne kemi bërë për drejtuesin e burgut të Fierit. Provohet në fakt ajo që ne kemi thënë, se në këtë burg ju kërkua punonjësve të administratës, por edhe të burgosurve të tjerë që të votonin numrin 10 në listën e Partisë Socialiste dhe po të shohim të dhënat e vendosura në dispozicion nga 67 vota për kandidat, 26 vota i ka marrë numri 10 i kësaj partie, Gramoz Ruçi ose 35.81 %. Jemi të bindur që nëqoftëse ky vullnet për të marrë prova, për të peovuar pretendimet që ngriti Partia Demokratike përpara këtij komisioni. Do të kshte ekzistuar edhe në raste të tjera, pra edhe në rastin e 90 kërkesave për marrjen e provave pranë organeve të administratës publike, ne do të kishim pasur sot mundësi të zbardhnim të plotë masakrën zgjedhore të 25 Prillit në Qarkun e Fierit. Ne si Parti Demokratike, në emër të Aleancës për Ndryshim kërkuam në mënyrë të përsëritur nga institucionet publike, qoftë kjo kërkesë e bërë publike në këtë sallë, qoftë 100 kërkesat për informacion që ne kemi dërguar pranë institucioneve publike, që të bënin transparencë të plotë se si ishin menaxhuar asetet dhe burimet shtetërore në periudhën 4 muaj përpara zgjedhjeve, pra janar-prill 2021 deri në datën e zgjedhjeve. Siç jeni në dijeni ne kemi marrë deri më sot zero informacion, asnjë përgjigje nuk ka srdhur nga asnjë institucion apo organ i administratës publike dhe fatkeqësisht në cënim të këtij procesi as nga ana e këtij komisioni,

15

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

pavarësisht se u përsëritën kerkesat tona në 9 seanca të ndryshme, plot 171 kërkesa janë refuzuar në vlerësimin tonë në kundërshtim me nenin 137 të Kodit Zgjedhor. Sigurisht që mosmarrja e provave të kërkuara, moskryerja e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, e cila është një kërkesë thelbësore e një procesi të rregullt ligjor, e ka cënuar këtë proces deri në atë masë sa ne dyshojmë shumë që e tillë do të jetë edhe vendimmarrja përfundimtare e këtij komisioni. Moskryerja e një hetimi të plotë e të gjithmanshëm, kryerja e një hetimi të paplotë ose të cunguar, sigurisht që nga pas sjell edhe rezultate të cunguara edhe në vendimmarrjen përfundimtare të këtij komisioni. Duke qënë se kjo është seanca e fundit që zhvillohet përpara këtij komisioni, pa paragjykuar vendimmarrjen, megjithëse kemi dyshimet tona. Për ne, të nderuar anëtarë të komisionit është e qartë dhe ka qënë në vetvete detyra jonë që të sjellim çdo fakt, çdo provë, çdo të dhënë dhe çdo indicje për t'a paraqitur përpara jush, të cilat në vlerësimin tonë faktonin të plotë masakrën zgjedhore të 25 Prillit. Ne kemi paraqitur mbi 600 faqe shpjegime të detajuara të gjitha shkeljeve ligjore që kanë ndodhur në 9 qarqet. Kemi paraqitur mbi 450 prova, qofshin këto shkresa, qofshin materiale filmike, foto dhe video. Kemi kërkuar në mënyrë të përsëritur dhe kemi paraqitur përpara këtij komisioni rreth 171 kërkesa për marrje provash pranë organeve të administratës publike dhe besojmë plotësisht që përpara të gjithë atyre shqiptarëve që në 25 prill i besuan Partisë Demokratike, e kemi kryer detyrën tonë, e cila sigurisht nuk ndalet këtu. Prandaj bazuar në gjithçka thamë më sipër, për gjithçka që ne kemi pasur mundësi të paraqesim dhe parashtrijmë përpara jush, qofshin këto në cilësinë e parashtrimeve dhe shpjegimeve tona të detajuara, qofshin këto në cilësinë e provës, kerkojmë përfundimisht shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, në zonen zgjedhore Qarku Fier dhe urdhërimin e përsëritjes së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë në këtë

16

*Zbardhi materialin audio  
Arlinda BAHOLLARI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

zonë, duke kërkuar në fakt që edhe në Qarkun e Fierit të zbatohen standartet e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe të barabarta dhe t'a kthejmë procesin zgjedhor në binarët e ligjshmërisë, faleminderit. Për sa i përket provës që sapo na u vu në dispozicion, do të kërkoja pak kohë që ta shohim dhe pastaj mbase mund të bëjmë ndonjë koment.

**Z. I. Rusmali:** Ja dëgjojmë edhe kolegen nga Lëvizja Socialiste për Integrim dhe ndërkohë ju e shihni dhe e konsultoni.

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Po, ne i nderuar jemi në mbështetje për sa i përket pretendimeve të ngritura nga Partia Demokratike.

**Z. I. Rusmali:** Mirë faleminderit! Zoti Logu doni 5 minuta pushim apo...

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Pa mikrofon, nuk dëgjohet.

**Z. I. Rusmali:** Edhe...5 minuta pushim dhe pastaj rikthehemi me analizën e kësaj prove.

**Rifillon Mbledhja**

**Ora:11:31**

**Z. I. Rusmali:** Mirë atëhere rikthehemi në seancë, fjala është për zotin Logu.

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Faleminderit zoti kryesues! Nga prova që na u vu në dispozicion, të paktën nga leximi që ne i bëmë, rezulton se në zgjedhjet e vitit 2017 në fshatin "Buz Madh", njësia administrative "Cakran", në 3 qendra votimi 3095, 3096, 3096/1 ka pasur 1.233 zgjedhës që kanë votuar, nga



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

të cilët 333 kanë votuar për Partinë Socialiste. Në terma përqindje, kjo do të thotë që përqindja e zgjedhësve që kanë votuar, pra përqindja e zgjedhësve që kanë marrë pjesë dhe kanë votuar për Partinë Socialiste është 31.06 %. Ndërkohë që në zgjedhjet e vitit 2021 kanë marrë pjesë në zgjedhje rreth 791 votues, në qendrat e votimit 3095, 3096. Në terma përqindje kjo është...791 votues nga të cilët 391 kanë votuar për Partinë socialiste, në terma përqindje kjo është 49.43% . Çka do të thotë se edhe në term absolute votash, për arsye së diferenca është pak më e vogël në terma absolute votash, pra është 8 vota më shumë në zgjedhjet e vitit 2021, por meqënëse për ne është e rëndësishme në terma përqindje, kemi një rritje me 18 % të numrit të votuesve për Partinë Socialiste në zgjedhjet e vitit 2021, çka edhe njëherë në vlerësimin tonë, vetëm bazuar mbi këto shifra që u vun në dispozicion dhe duke i marrë të mirëqëna se ashtu janë, rezulton që ndikimet ose ndikimet e paligjshme, qofshin këto punësimet, blerje votash etj... kanë ndikuar edhe në rritjen e rezultatit për Partinë Socialiste në fshatin “Buz Madh”, njësia administrative “Cakran” me 18 % nga zgjedhjet e vitit 2017 në zgjedhjet e vitit 2021. Ky është komenti që ne kemi, për më shumë kemi pasur mundësinë t’ a parashtrojmë edhe në kërkesën tonë ankimore faktet që lidhen me këtë zonë dhe me këto qendra votimi, faleminderit.

**Z. I. Rusmali:** Faleminderit! Pyetje, ndoshta sqaruese për rënien drastike të numrit të votuesve nga njëri votim në tjetrin, keni ndonjë analizë, shpjegim, apo jo? Votuesve, jo të zgjedhësve. Votuesit bien nga 1.233 në 791. Domethënë bien me...

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** Arsyet mund të jenë të shumta, mund të ketë edhe lëvizje demografike. Sigurisht që nuk ka përse i përket....



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

**Z. I. Rusmali:** Jo, nuk ka nevojë për hipoteza, nëqoftëse keni, nëqoftëse nuk keni...

**Z. M. Logu, përfaqësues i PD-së:** kemi dy gjera të themi që mund të kenë ndikuar. Pastaj po të themi, vërtetimi i takon këtij komisioni sesa... E para domethënë është fakti i njohur publik që në vitet e fundit nga Shqipëria janë larguar rreth 400.000 shqiptarë. Unë besoj që ky proces nuk ka qëndruar pa ndikuar edhe në fshatin "Buz Madh" në njësinë administrative "Cakran". Kjo mund të jetë arsyeja e parë dhe arsyeja e dytë të cilën ne kemi pasur mundësinë t'a parashtrijmë dhe relatojmë në mënyrë të përsëritur përpara këtij komisioni, është fakti se shumë nga votuesit dhe mbështetësit e opozitës, qofshin këta votues të Partisë Demokratike, qofshin votues të Lëvizjes Socialiste ju janë marrë kartat e identitetit, janë kërcënuar, janë vendosur nën presion për të mos votuar, çka mendojmë se mund të shpjegojë edhe uljen e numrit të votuesve. E në çdo rast numri i votuesve është ulur, pra i zgjedhësve është ulur, por nuk janë ulur votat për Partinë Socialiste, të cilat përkundrazi janë rritur edhe në numër absolute votash, por edhe në përqindje çka është domethënëse, pra një rritje me 18 % mendojmë që është domethënëse. Nëqoftëse do të jetë me interes për hir të këtij komisioni sigurisht që mund të marrim informacione nga strukturat lokale të Partisë Demokratike të fshatit "Buz Madh" për të kuptuar më mirë fenomenin e rënies drastike të numrit të zgjedhësve.

**Z. I. Rusmali:** Mirë faleminderit! Për ne besoj është mjaftueshëm ky eksplorim që kemi bërë dhe mund të na ndihmojë në arritjen e konkluzioneve tona. Përfaqësuesja e LSI-së ka koment për këtë gjë? Për këtë provën?



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve  
Dt.31.05.2021*

**Znj. S. Caka, përfaqësuese e LSI-së:** Jo, nuk kemi.

**Z. I. Rusmali:** Mirë, faleminderit! Mbyllim këtu gjithçka dhe KAS tërhiqet për të marrë vendim. Besoj për 20 min apo më shumë? Për 20 minuta ne rikthehemi në seancë për të shpallur vendimin.

**Rifillon Mbledhja**

**Ora:12:16**

**Z. I. Rusmali:** Mirë, rifillojmë seancën për shpalljen e vendimit. Mbështetur në shkronjën “d” të nenit 143 të Kodit Zgjedhor dhe në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 30 të vendimit nr. 3, dt. 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, KAS vendosi rrëzimin e Kërkesës Ankimore nr. 44 të subjektit zgjedhor PD – AN për shpalljen e pavlefshme të zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Fier, të pambështetur ne ligj dhe në prova. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 348, dt. 04.05.2021 për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit, në zonën zgjedhore Qarku Fier, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit brenda 5 ditëve nga hyrja në fuqi e tij. Me shpalljen e këtij vendimi mbyllet shqyrtimi i kësaj kërkesë ankimore. Seanca deklarohet e mbyllur. Faleminderit!

**Vendimi nr. 95**

